

## **Mbi Auditimin e Ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizimeve (DPUK)**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në DPUK, me objekt “Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik dhe financiar” për periudhën 01.01.2012 deri 30.9.2013 si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së Nr. 731/8, datë 30.12.2013.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” me ndryshime, me shkresën nr. 731/9 datë 30.9.2013 Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar z.Ardian ALUSHI, Drejtor i Përgjithshëm.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik, zhvilluar gjatë vitit 2012 nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve (DPUK), u konstatuan raste të **mos arkëtimit nga Autoriteti Kontraktor i sigurimit të kontratës**, në kundërshtim me pikën 2/ë, të kreut III, të VKM-së nr.1, datë 10.1.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime. Theksojmë se sigurimi i kontratave në shumicën e rasteve është në vlera të konsiderueshme. Më konkretisht, i referohemi konstatimit lidhur me tenderin “Supervizion punimesh për objektin Kolektori i Ujrave të përdorura D=1200 mm, impianti i trajtimit në Vlorë”, ku kompania e sigurimeve ■■■ në kundërshtim me Dokumentat Standarde të Tenderit për Kontratat e Punëve Civile, të miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, shtojca 13, nuk ka konfiskuar sigurimin e kontratës për tërheqje të pa motivuar në ligj të kontraktuesit, për llogari të Autoritetit Kontraktor i cili nuk ka arritur të arkëtojë **vlerën e sigurimit të kontratës duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit**.

- Sipas pikës 2/ë të kreut III, të VKM-së nr.1, datë 10.1.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime, sigurimi i kontratës në vlerën 10% të saj, garanton autoritetin kontraktor në rastet e shkeljes së kontratës dhe ka formën e një depozite apo garancie të lëshuar nga një bankë ose shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti. Gjithashtu dhe Dokumentat Standarde të Tenderit për Kontratat e Punëve Civile, të miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, në shtojcën 13 ”Formulari i sigurimit të kontratës”, përcaktojnë qartë detyrimin e kompanive të sigurimit apo bankave për sa vijon “*Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e (emri i autoritetit kontraktor) vlerën e siguruar, brenda 15 ditëve nga kërkesaj juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e kushteve të kontratës.*”

Auditimi tregoi se në praktikë gjatë aplikimit të ligjit për prokurimet publike, akteve në zbatim të tij, është bërë i pamundur arkëtimi nga Autoritetet Kontraktore i konfiskimit të vlerave të sigurimit të kontratës, kryesisht atyre të siguruara në kompanitë e sigurimit duke shtuar rastet e abuzimeve me sigurimin e kontratave. Ndodhur në këto kushte, gjejmë se duhet të bëhet rregullim ligjor në mënyrë që sigurimi i kontratës të bëhet pranë bankave dhe jo kompanive të sigurimit, pasi ato janë bërë pengesë në zbatimin e DST dhe akteve nënligjore, kjo edhe për faktin e mos ndëshkimit të këtyre shoqërive të sigurimeve në rastet e shkeljes së ligjit dhe pse legjislacioni civil ka parashikuar rastet për kërkimin e dëmit.

Meqënëse procedurat e prokurimit publik rregullohen nga aktet ligjore për prokurimin publik, për të siguruar garantimin e arkëtimit të vlerës së sigurimit të kontratave si dhe për të evituar zgjatjen maratonë të konflikteve që mund të rezultojnë në sigurimin pranë kompanive të

sigurimit kërkojmë të bëhet përmirësim ligjor në DST si dhe në aktet nënligjore duke rekomanduar që:

1-Të kërkohej nga Këshilli i Ministrave, **ndryshimi** në pikën 2/ë, të kreut III, të VKM-së nr.1, datë 10.1.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime, **sigurimi i kontratës të bëhet vetëm pranë bankave**, duke hequr të drejtën e sigurimit pranë kompanive të sigurimit, për të evituar në këtë mënyrë rastet abuzive në konfiskimin e sigurimit.

2- Agjencia e Prokurimit Publik, të bëjë ndryshimet dhe shtesat e nevojshme deri sa të bëhen rregullimet ligjore të kërkuara në pikën 1 të rekomandimit, në Dokumentat Standarde të Tenderit për Kontratat e Punëve Civile, shtojca 13 “Formulari i sigurimit të kontratës” ku: **Të vendosë sanksione “gjobë” për shoqëritë e sigurimeve në rastin e mospërbushjes së detyrimit nga ana e tyre për konfiskimin e sigurimit të kontratës** për llogari të Autoriteteve Kontraktore, në momentin e tërheqjes të pa bazuar në ligj të kontraktuesit nga realizimi i kontratës, duke e konsideruar këtë veprim kundravajtje administrative.

3- Të kërkohej nga Këshilli i Ministrave, të bëhen shtesa në nenin 49 të ligjit nr. 9643, datë 26.12.2007 me ndryshime, duke u shtuar një paragraf i cili të parashikojë dhe sigurimin e kontratës, mënyrën e konfiskimit si dhe rastet kur duhet të konfiskohet sigurimi i kontratës.

**Menjëherë**

## **B. MASA ORGANIZATIVE**

1.Nga auditimi i *hartimit dhe zbatimit të buxhetit* rezultoi se në kundërshtim me ligjin organit të buxhetit, DPUK nuk ka të pasqyruara drejt dhe saktë të gjitha detyrimet sipas operatorëve ekonomikë, gjithashtu nuk ka një ndarje të drejtë të tyre në detyrime afatshkurtra dhe afatmesme, që do të ndihmonte në një planifikim të kujdesshëm të nevojave për fonde në vitet në vijim pa harruar domosdoshmërinë e përcaktimit të saktë të borxhit ndaj operatorëve ekonomikë për punë publike, mallra apo shërbime. Kjo problematikë u konstatua edhe nga auditimi i organizimit dhe mbajtjes së kontabilitetit pasi në kontabilitet, nuk është zbatuar parimi i **të drejtave të konstatuara**, pra të regjistroheshin transaksionet ekonomike pavarësisht faktit nëse shoqërohen me lëvizje të cash-it që do të thotë se regjistroheshin të drejtat dhe detyrimet kur ato lindin. Aplikimi i këtij parimi (**të drejtave të konstatuara**), bën të mundur nxjerrjen në çdo moment dhe me saktësi në pasqyrat financiare, të vlerës së detyrimeve të lindura bazuar në kontratat fillestare si dhe vlerës së punimeve të kryera dhe të pranura. Sipas të dhënave ekstrakontabël që disponon sektori i financës për financimin e kontratave deri më 31.12.2012 për projektet me financim nga DPUK rezulton se:

- Vlera totale e kontraktuar është	<b>2,697,519,584</b> lekë
- Vlera e financuar deri më 31.12.2011	1,584,403,383 lekë
-Vlera e financuar gjatë vitit 2012	519,879,598 lekë
-Vlera totale e financuar deri më 31.12.2012	<b>2,104,282,981</b> lekë
Shuma e mbetur për financim më 31.12.2012	<b>592,836,585</b> lekë

### **Sa me sipër, rekomandoj:**

-Pasqyrimin e saktë në kontabilitet dhe dhënien e shënimeve të plota shpjeguese për detyrimet sipas klasifikimit në afatshkurtra dhe afatmesëm që do të ndihmonte në planifikimin e drejtë të shlyerjes së tyre në buxhetet afatshkurtra dhe afatmesëm.

- DPUK të bëjë rregullimet kontabël që në Pasqyrat Financiare të institucionit të pasqyrohen jo vetëm detyrimet por dhe angazhimet e marra si detyrime jashtë bilancit, këto të fundit të shoqëruara me shënime të zgjeruara në pasqyrat financiare.

**Menjëherë**

2. Auditimi mbi *zbatimin e buxhetit* tregoi se pavarësisht politikave dhe përpjekjeve të qeverisë për reduktimin e subvencioneve nga viti në vit deri në nivelin e atyre të domosdoshme, nga ana e stafëve menaxheriale të shoqërive si dhe nga njësitë e qeverisjes vendore nuk kristalizohen angazhime të qarta në lidhje me këtë çështje. Procesi i decentralizimit, synonte eliminimin e subvencioneve nga buxheti i shtetit dhe zëvendësimin e tyre nga mjetet e realizuara përmes aktivitetit dhe në rastet e pamundësive financiare plotësimin e tyre nga burime të qeverisjes vendore nëpërmjet mekanizmave të mirëstudiuar. Situata e deritanishme pasqyron problemet të tilla si akumulim të borxheve, mungesë të treguesve bindës të performancës së tyre dhe ajo që është më shqetësuese indiferencë të këtyre kompanive për shkak të mbulimit të pagave nga qeverisja qëndrore.

**Sa me sipër, rekomandoj:**

-MTI dhe DPUK në bashkëpunim me EREU-n të bashkëpunojnë në rikonceptimin e modelit të subvencioneve të shoqërive të ujesjellës kanalizimeve dhe vendosjen e parametrave ekonomik e financiar që duhet të arrijnë këto njësi për përfitimin e subvencioneve për të mundësuar kështu rritjen e ndërgjegjësimit dhe përgjegjësisë së tyre drejt një menaxhimi efektiv.

**Menjëherë**

3. Nga shqyrtimi i *zbatimit të vendimeve të miratuara nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve* “Për shpërndarjen e Fondeve të Zhvillimit të Rajoneve” u konstatua se:

- Skema e Grandit Konkurrues nuk garanton konsultime me qarqet dhe bazohet në kritere të cilat kërkojnë një verifikim të pavarur të të dhënave të raportuara nga Njësitë e Qeverisjes Vendore gjë e cila nuk bëhet.

- DPUK nuk verifikon nëse këto investime janë në përputhje me Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rajonal. U konstatua se shpërndarja gjeografike e projekteve mbulonte zona shumë të afërta me njëra tjetrën, duke krijuar nevojën e një masterplani i cili të mbulonte zonën me shërbimet e një ujësjellësi dhe eliminonte praktikën e deritanishme të disa ujësjellsave në cdo fshat, kjo do të reduktonte kostot si në investim dhe në operim.

- Projektet që propozohen nga NJQV pa kryer konsultime me administratat e qarqeve të cilat mund të luajnë një rol të veçantë në mbështetjen e NJQV-ve për të hartuar propozimet e tyre për projekte, ose për të asistuar në investimet prioritare brënda qarkut të tyre. Kjo skemë është totalisht e pa monitoruar nga DPUK apo dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.

**Sa me sipër, rekomandoj:**

-DPUK në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës t’i propozojë Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve rishikimin e Vendimeve të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve “Për përcaktimin e kritereve për ndarjen e fondit për Zhvillimin e Rajoneve” lidhur me vendosjen e kritereve më të qarta për alokimin e fondeve të investimeve dhe grandeve konkurruese si dhe aplikimin e tyre në mënyre konsistente. Rëndësi kritike ka fakti që në alokimin e grandeve të marrë prioritet nevoja por dhe performanca e këtyre njësive dhe alokimi të bazohet në negociata të vazhdueshme me qarqet sipas Strategjisë ndërsektoriale të zhvillimit rajonal.

-Detyrimin që Sektori i Investimeve pranë Drejtorisë Ekonomike si dhe Drejtoria e Programit të DPUK-s, të ndjekë në dinamikë prioritetet e planifikimit të investimeve për objektet ndërtimore të financuara prej saj, të mbështesi në kohë reale sigurimin e burimeve të financimit të harmonizuara me afatet kohore të ndërtimit të objekteve dhe të jetë pjesëmarrëse aktive për ndjekjen, monitorimin, financimin dhe dorëzimin e objekteve që financohen nëpërmjet Fondeve të zhvillimit Rajonal.

**Menjëherë**

4. Auditimi konstatoi se çelja e fondeve vjetore është bërë në mënyrë pjesore dhe në vlera të vogla, duke rezultuar ndërtime në proces të pa mbuluar *me fonde*, praktikë që ka sjellë shtyrjen e realizimit të investimeve për dy apo më shumë vite buxhetore por nga ana tjetër duke krijuar veshitësi në likuiditete për sipërmarrjet private, të cilët kanë kontrata për punë apo shërbime me sektorin publik.

***Sa me sipër, rekomandoj:***

-Në PBA të zbatimit të buxhetit për periudhën në vijim, të vendoset kriteri i përgjithshëm i moscoptimit të fondeve të investimeve publike për të gjitha investimet e kontraktuara, apo punimet të cilat rezultojnë të realizuara dhe nuk janë financuar për vitin ushtrimor.

- Për të gjitha projektet e investimeve “objekte të reja” të synohet në financimin e projekteve në vlerën e plotë të projektit, kur vlera e tyre është e realizueshme brënda vitit buxhetor.

**Menjëherë**

5. Duke parë vijueshmërinë e investimeve në vite si nga Buxheti i shtetit dhe nga Financimi i Huaj dhe menaxhimin e bërë nga DPUK, u konstatua se kjo Drejtori nuk ka një database i cili të përmbajë çdo investim të kryer në infrastrukturën ujore, që në mënyrë kronologjike të japi një historik të detajuar mbi çdo financim dhe inventar fizik të këtyre investimeve apo projekteve. Gjykojmë se ekzistenca e një database të tillë do të shërbente vetë DPUK-s për planifikimin real të çdo investimi duke shmangur dublime të investimeve, duke ju përqsaur një strategji sektoriale afër nevojave reale të çdo qarku në Republikën e Shqipërisë.

***Sa me sipër, rekomandoj:***

- DPUK të marrë masa urgjente për ngritjen e një database që të përmbajë çdo investim të bërë në infrastrukturën ujore dhe në mënyrë kronologjike të japi një historik të detajuar mbi çdo vlerë financimi dhe inventar fizik të këtyre investimeve apo projekteve.

- Përditësimin e hartës dixhitale GIS, ku të përfshihet i gjithë sistemi i furnizimit me ujë së bashku me informacionin e saktë dhe të detajuar të mirëmbajtjes së tij duke treguar qartë me ngjyrë dalluese rrjetin në funksion, pjesën e rrjetit që ka nevojë për shërbim si dhe zonat me risk, e cila duhet të përditësohet çdo vit.

- Përditësimi i hartës dixhitale të cituar në paragrafin e dytë të rekomandimit të shërbejë edhe planifikimit më të drejtë të territorit në NJQV duke vendosur parametra sa më të drejtë lidhur me rrezën e ndalimit të ndërtimeve dhe prishjen e atyre ekzistuese kur janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, për qark burimeve ujore, stacioneve të pompave dhe rrjeteve kryesore të furnizimit me ujë.

**Menjëherë**

6. Referuar konstatimit që në strukturën dhe organigramën e DPUK-s nuk ka gjetur zbatim vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 474, datë 16.6.2011 “Për përcaktimin e standardeve e të procedurave që duhet të ndiqen gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike”, në kundërshtim me pikën 49, dhe kreun e I-rë të këtij vendimi i cili përcakton se: “Brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, për institucionet në fushën e ekzekutivit, dhe 2 (dy) vjetëve, për institucionet e tjera, strukturat organizative duhet të përshtaten sipas standardeve të përcaktuara në kreun I, të këtij vendimi”, fakt që ka sjellë një përdorim jo efektiv i fondeve buxhetore në shumën rreth **2,667 mijë** lekë.

***Sa më sipër rekomandoj:***

DPUK të marrë masat e duhura për përshtatjen e strukturës organizative të saj me standardet e përcaktuara në kreun e I-rë të VKM nr. 474, datë 16.6.2011, në funksion edhe të përgjegjësive që duhet të mbajë gjithsecili në realizimin e misionit të këtij institucioni për të arritur një nivel efience të plotë të përdorimit të fondeve në dispozicion.

**Menjëherë**

7. Nga auditimi i shpenzimeve të kryera nga DPUK, për *largimet nga puna të punonjësve* rezultoi se, nga zgjidhja e menjëhershme dhe e pajustificuar e kontratës së punës për 4 (katër) punonjës, është paguar nga zëri shpenzime operative shuma **6,011 mijë lekë**, e cila përbën përdorim jo efektiv të fondeve buxhetore (detyrim i përbërë për pagat në shumën 5,682,870 lekë dhe detyrimet gjyqësore e përmbartimore në shumën 328,412 lekë). Gjithashtu nga mos likuidimi në kohë i diferencës së kontratës së lidhur me shoqërinë “SCAI” shpk për objektin “*Ndërtim i ujësjellësit Lazarat*” është paguar penalitet nga zëri shpenzime operative shuma **547,6 mijë lekë**, e cila përbën përdorim jo efektiv të fondeve buxhetore. Në total shuma **6,559 mijë lekë** përbën përdorim jo efektiv të fondeve buxhetore. Për asnjërin nga rastet e cilësuar më sipër nuk është bërë analizë për humbjen e shkaktuar dhe nuk është nxjerrë përgjegjësia ndaj shkaktarëve.

**Sa më sipër rekomandoj:**

Me qëllim që të rritet përdorimi efektiv i fondeve buxhetore nga DPUK Tiranë të analizohen shkaqet e largimit padrejtësisht nga puna të punonjësve dhe për mos likuidimin në kohë të detyrimeve kontraktore të nxirret përgjegjësia ndaj shkaktarëve në mënyrë që situata të tilla të mos përsëriten në të ardhmen.

**Menjëherë**

8. Gjatë auditimit të *situacioneve* të hartuara nga sipërmarrësit dhe të miratuara nga DPUK, në 4 (katër) raste u konstatua se, ato nuk janë hartuar në përputhje kërkesat e UKM nr. 2, datë 15.2.2001 “*Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit*” dhe me formatin tip që i bashkëlidhet Udhëzimit nr. 1, datë 16.6.2011 “*Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar*” pasi është llogaritur dhe shtuar në vlerën totale të situacionit, tvsh 20% mbi vlerën e zërit makineri e pajisje duke rritur në mënyrë jo të drejtë vlerën e situacioneve përfundimtar të punimeve në shumën **2,391 mijë lekë**.

**Për sa më sipër rekomandoj:**

-DPUK të analizojë për çdo objekt dhe të nxjerrë përgjegjësitë ndërmjet hartuesve të preventivave të punimeve që kanë shërbyer për lidhjen e kontratave dhe personelit teknik të DPUK që kanë për detyrë kontrollin dhe miratimin e situacioneve të punimeve të kryera të cilët kanë vepruar në kundërshtim me kërkesat e UKM nr. 2, datë 15.2.2001, i ndryshuar duke llogaritur e shtuar padrejtësisht TVSH-së mbi vlerën e zërit makineri e pajisje nëpërmjet trajtimit të tyre si mallra të blera, duke rritur vlerën e punimeve faktike për realizimin e të katër objekteve të cilësuar në Raport në shumën 2,390,760 lekë, e përkatësisht; për objektin “*Ndërtim i Ujësjellësit të Jashtëm të Qytetit B.Curri*” në shumën 220 000 lekë; për objektin “*Furnizimi me ujë zona Balldre Torroviç*” në shumën 722,760 lekë; për objektin “*Furnizimi me ujë i Qytetit Kukës dhe 14 fshatrave*”, në shumën 990,000 lekë dhe për objektin “*Ujësjellësi i Ksamilit, faza e II-të*”, në shumën 458,000 lekë.

**Menjëherë**

9. Referuar *auditimit për administrimin e pronës shtetërore*, rezultoi se gjatë inventarizimit të vlerave materiale komisioni i inventarizimit nuk ka evidentuar 11 artikuj me vlerën 2,199,974 lekë jashtë përdorimit, deri në përfundim të auditimit nga DPUK, nuk kanë nisur procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimit të artikujve të cilësuar si jashtë përdorimit. Gjithashtu rezultoi se në vlerën e inventarit ekonomik prej 11,395,219 lekë të pasqyruar në Aktivin e Pasqyrave Financiare përfshihet edhe shuma 561,175 lekë që përfaqëson aktive që nuk plotësojnë kufirin minimal prej 10,000 lekë i përcaktuar si pragu i vlerësimit të aktiveve afatgjata.

**Për sa më sipër rekomandoj:**

-DPUK të nisë procedurat për vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të 11 artikujve me vlerën **2,199,974 lekë** në përputhje pikat 95-120 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011.

- DPUK të bëjë sistemimet e duhura në kontabilitet, duke debituar llogarinë 32 “Inventar i imët” për shumën 561,175 lekë në kredi të llogarisë 218 “Inventar ekonomik” në përputhje me rregullat për mbajtjen e kontabilitetit të përcaktuara me ligjin nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe në pikën 29, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011.

**Menjëherë**

**10.** Referuar vlerësimin të sistemeve të funksionimit të kontrollit të brendshëm nga auditimi u konstatua se për vitin 2012 dhe 9 mujorin 2013, titullari i Njësisë Publike (DPUK), në cilësinë e Nëpunësit Autorizues ka emëruar Nëpunësin Zbatues në kundërshtim me nenin 12/1 të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 dhe nenin 16,18/3 të Ligjit nr.90, datë 27.9.2012, pasi në institucionet e varësisë direkte Nëpunësi Zbatues duhet të jetë nivel menaxherial (Drejtor) në varësi direkte të drejtuesit të institucionit, gjithashtu konstatohet se Nëpunësi Zbatues nuk plotëson dhe kriterin e arsimit, si në rastin konkret ku në cilësinë e Nëpunësit Zbatues për vitin 2013, është emëruar Zv/Drejtori i Përgjithshëm i cili është me arsim të lartë inxhinier mekanik.

*Gjithashtu dhe nga ana e Nëpunësit Zbatues, delegohen kompetencat në kundërshtim me nenin 12 të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010.*

Nuk janë bërë ndryshimet e nevojshme ligjore në Rregullore e Brëndshme të DPUK në lidhje me zbatimin e kërkesave të Ligjit nr.10.296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

***Për sa sipër rekomandoj:***

-Të merren masa për caktimin e Nëpunësit Zbatues, në përputhje me kërkesat e nenit 12 të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, nenin 12/1 të Ligjit 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” në drejtim të plotësimin të kriterit të arsimit dhe ligjit nr.90, datë 27. 9.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, neni 16 dhe neni 18 pika 3 në drejtim të përmbushjes së varësisë direkte. Të njoftohet Nëpunësi Autorizues i MTI për caktimin e Nëpunësit Zbatues në DPUK.

**Menjëherë**

## **C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**1.** Nga auditimi i shpenzimeve të kryera për udhëtim e dieta brenda vendit rezultoi se, në 9 raste janë paguar padrejtësisht dieta në shumën 97,000 lekë për shërbime të kryera në distanca më të vogla se 100 km nga qendra e punës, në kundërshtim me kreun III-të pika 1, të VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, ku përcaktohet se “1. Për shërbime në një largësi deri në 100 km jashtë qendrës së punës, trajtimi financiar i punonjësit përfshin vetëm shpenzimet e transportit, në rastet kur transporti nuk realizohet nga institucioni,...”. Për këto raste rezultoi se punonjësit kanë përfituar dieta për shërbime të kryera në distanca nën 100 km, në Qytetin Shkodër të cilët sipas urdhrit të Ministrit të PPT nr. 125, datë 26.12.2011 “Për miratimin e hartave të azhurnuara të rrjetit kombëtar dhe të distancave kilometrike ndërmjet qyteteve të Shqipërisë”.

***Për sa më sipër rekomandoj:***

-Të kërkohej në rrugë administrative bazuar në Kodin e Procedurave Administrative si dhe në rrugë ligjore bazuar në Kodin Civil, shpërblimi i dëmit ekonomik, në shumën **97,000 lekë gjithsej** nga personat përfitues sipas trajtimit të bërë në faqen 40-41 të Raportit Përfundimtar, marrë në kundërshtim me kreun III-të pika 1, të VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”.

## Menjëherë

2. Të kërkohet në rrugë administrative bazuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe në rrugë ligjore bazuar në Kodin Civil, shpërblimi i dëmit ekonomik në shumën **990,000 lekë** nga [REDACTED] e cila ka përfituar padrejtësisht nga përlllogaritjet e gabuara të bëra në tabelën përmbledhëse të situacionit nr. 8, ku shuma e TVSH është 67,128,737 lekë dhe jo 68,118,737 lekë ose **990, 000 lekë** më tepër se shuma që është shënuar në përmbledhësen mbi të cilën është bërë likuidimi, për objektin “*Furnizimi me ujë i Qytetit Kukës dhe 14 fshatrave*”.

Menjëherë

3. Nga auditimi mbi *zbatimin e kontratave të punëve publike* rezulton të ketë punime të pakryera në vlerën **5,678,743** lekë gjithsej, e cila përbën **dëm ekonomik për buxhetin e shtetit** përkatësisht në tenderin me objekt “Kolektori i Ujrave të ndotura, D=1200 mm, impianti i trajtimit në Vlorë” përfituar padrejtësisht në vlerën **4,464,793** lekë nga [REDACTED] dhe në tenderin “Ndërtim i kolektorit të ujrave të zeza Sarandë, lidhja IPUZ”, në vlerën **1,213,950** lekë, përfituar padrejtësisht [REDACTED]

*Për sa sipër rekomandoj:*

-Të kërkohet në rrugë administrative bazuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe në rrugë ligjore bazuar në Kodin Civil, shpërblimi i **dëmit ekonomik** gjithsejt në vlerën **5,678,743** lekë përkatësisht:

- Për tenderin me objekt “Kolektori i Ujrave të ndotura, D=1200 mm, impianti i trajtimit në Vlorë”, për punime të pakryera në vlerën **4,464,793** lekë, përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi [REDACTED]

- Në tenderin “Ndërtim i kolektorit të ujrave të zeza Sarandë, lidhja IPUZ”, për punime të pakryera në vlerën **1,213,950** lekë, përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve BOE [REDACTED]

Menjëherë

4. Nga auditimi mbi *zhvillimin e procedurave të prokurimit* dhe konkretisht në tenderin me objekt “**Supervizion punimesh për objektin Kolektori i Ujrave të përdorura D=1200 mm, impianti i trajtimit në Vlorë**”, konstatohet se personit fizik [REDACTED] nuk i është konfiskuar sigurimi i kontratës nga Kompania e Sigurimeve “Atlantik” sh.a .për shkak të dorëheqjes së pa motivuar nga realizimi i kontratës në **vlerën 74,000 lekë**.

*Për sa sipër rekomandoj:*

-Të kërkohet nga [REDACTED] në rrugë administrative mbështetur në Kodin e Procedurave Administrative si dhe në rrugë ligjore bazuar në Kodin Civil, konfiskimi i sigurimit të kontratës në **vlerën 74,000 lekë**, për kontraktuesin [REDACTED] bazuar dhe në kushtet e kontratës nr. 1618, datë 20.6.2013, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit për tenderin me objekt “Supervizion punimesh për objektin Kolektori i Ujrave të përdorura D=1200 mm, impianti i trajtimit në Vlorë

Menjëherë

## D. MASA ADMINISTRATIVE

1.Nisur nga konstatimi mbi auditimin e procedurës së tenderit “**Ndërtim i Kolektorit Kryesor të Ujrave të Zeza, Sarandë, derdhja në IPUZ**” ku zbatuesi i punimeve **Arbëria sh.a.&Harmonia sh.p.k.** nuk ka depozituar në seksionin e urbanistikës në rreth apo bashki, relacionin së bashku me dokumentacionin përkatës në dy kopje për plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga neni 9 i Ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e

punimeve të ndërtimit”, me ndryshime, veprim ky në kundërshtim me nenin 11 të ligjit të sipërcituar, ku për pasojë kopja e relacionit nuk është marrë dhe nga **mbikqyrësi i punimeve shoqëria ”Derbi-E” sh.p.k** pas konfirmimit për depozitim, në mënyrë që ti jepej investitorit për kolaudimin e objektit.

***Sa më sipër rekomandoj:***

-Të kërkohet nga Kryinspektori i Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar bazuar në ligjin nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, neni 15 dhe ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, neni 5 të gjobisë në masën **500,000 lekë:**

Për mospërbushjen e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga neni 9 dhe 11 i Ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me ndryshime pasi nga zbatuesi i punimeve nuk është depozituar në seksionin e urbanistikës në rreth apo bashki, relacioni së bashku me dokumentacionin përkatës dhe si dhe mos paraqitja e tij investitorit për kolaudimin e objektit “Ndërtim i Kolektorit Kryesor të Ujrave të Zeza, Sarandë, derdhja në IPUZ” nga mbikqyrësi i punimeve.

**Menjëherë**

2. Nisur nga konstatimi mbi auditimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit, në objektin “**Kolektori i Ujërave të ndotura, D=1200 mm, impianti i trajtimit në Vlorë**”, të zhvilluar në vitin 2013, administruar në dosjen teknike, rezultojnë diferenca për punime të pakryera në vlerën prej 4,464,793 lekë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe që është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve, për shkak të mospërbushjes së detyrimeve ligjore që rrjedhin nga neni 7 i Ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me ndryshime [REDAKTUAR], në cilësinë e mbikqyrëses së punimeve ku për pasojë ka lejuar krijimin e punëve të pakryera.

***Sa më sipër rekomandoj:***

-Të kërkohet nga Kryinspektori i Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar bazuar në ligjin nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, neni 15 dhe ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, neni 5, të gjobisë në masën **50,000 lekë:**

Për mospërbushjen e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga neni 7 i Ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” me ndryshime, që ka sjellë si pasojë krijimin e punëve të pakryera në vlerën 4,464,793 lekë. ”.

**Menjëherë**

3. Nga auditimi mbi procedurat e prokurimit zhvilluar për vitin 2012-2013, janë konstatuar shkelje procedurale nga KVO në tenderin “**Furnizimi me ujë i plazheve Durrës Kavajë nga pusshpimet e Çermës loti III, Linja e ujësjellësit me presion nga ura e Rrogozhinës pik 235, degëzim Kavajë deri në Depon e re Arapaj, ndërtim Depo e re Durrës**”, trajtuar më hollësisht në Raportin e Përfundimtar të auditimit.

***Për sa sipër rekomandoj:***

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” i ndryshuar dhe ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 7, pika 2, 3/a, i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, që:

Në zbatim të nenit 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu X, të **gjobitë** në masën **100.000 lekë** anëtarët e KVO:





Për shkeljet procedurale të konstatuara në tenderin “**Furnizimi me ujë i plazheve Durrës Kavajë nga pusshpimet e Çermës loti III; Linja e ujësjellësit me presion nga ura e Rrogzhihës pik 235, degëzim Kavajë deri në Depon e re Arapaj (4000 m<sup>3</sup>), ndërtim Depo e re Durrës (4000 m<sup>3</sup>)**”, trajtuar hollësisht në Raportin Përfundimtar të auditimit fq 64-67.

## **E. MASA DISIPLINORE**

1. Nga auditimi mbi procedurat e prokurimit për vitin 2012 u konstatuan shkelje të legjislacionit për prokurimet publike dhe konkretisht në tenderin me objekt “Furnizim me ujë i zonës së Kënetë, Durrës zona 8-14 (shtesë kontrate), vlerë kontrate **38,520,000** lekë është konstatuar shmangie nga procedurat e prokurimit në kundërshtim me nenin 28 të LPP, kreu II, pika 1/c e VKM nr.1, dt 10.1.2007, të cilat kanë çuar në mungesën e konkurrencës dhe lindjen e pabarazisë së pjesmarrësve në tender, në kundërshtim me nenin 33, pika 5/a të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 me ndryshime, pasi nuk ekzistojnë kushtet për përzgjedhjen e procedurës së tenderimit “Negocim pa shpallje paraprake” trajtuar më hollësisht në Raport.

Gjithashtu nga auditimi mbi vlerësimin e sistemeve të funksionimit të kontrollit të brendshëm rezultoi se për vitin 2012 dhe 9 mujorin 2013, titullari i Njësisë Publike (DPUK), në cilësinë e Nëpunësit Autorizues nuk ka depozituar te Nëpunësi i Parë Autorizues **deklaratën dhe raportin** përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në kundërshtim me nenin 18, të Ligjit nr.10.296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

### ***Për sa sipër rekomandoj:***

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” i ndryshuar, nenit 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në zbatim të kontratës individuale/kolektive të punës dhe Rregullores së Brendshme, kërkohet dhënien e masës disiplinore:

-Masa ti komunikohet edhe institucionit ku aktualisht është i punësuar

**Menjëherë**

2. Nga auditimi mbi procedurat e prokurimit zhvilluar për vitin 2012, janë konstatuar mangësi dhe shkelje procedurale nga KVO në tenderat “**Ndërtim Ujësjellësi Rajonal Novosej-Shishtavec-Borje, Komuna Shishtavec Kukës**” dhe “**Ndërtim i Kolektorit Kryesor të Ujrave të Zeza, Sarandë, derdhja në IPUZ**”, trajtuar më hollësisht në Raportin e Përfundimtar të auditimit.

### ***Për sa sipër rekomandojmë:***

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” i ndryshuar dhe ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 7, pika 2, 3/a, i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, që:

Në zbatim të nenit 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu X, APP t’i propozojë titullarit të AK, marrjen e masave disiplinore për anëtarët e KVO:



## F. KALLËZIM PENAL

1. Nga auditimi mbi marrjen në dorëzim të objektit “Rrjeti i ri KUZ i fshatit Mbrostar-Ura faza e parë, Komuna Mbrostar Fier” rezulton se është financuar nga buxheti i shtetit në vlerën **56,926,557** lekë me TVSH, ndërtimi i “Rrjetit të fshatit Mbrostar /Ura faza e parë Komuna Mbrostar Fier” e cila është marrë në dorëzim provizor nga ish Kryetari i Komunës ■■■ në një kohë që objekti është jashtë funksionit si pasojë e mungesës së studimit gjeologjik të paparashikuar nga projektuesi, e cila ka qënë evidente gjatë gjithë kohës së zhvillimit të punimeve. Për pasojë, megjithë problemet e konstatuara në ndërtimin e objektit nga ana e kolaudatorit dhe ish Kryetarit të Komunës Mbrostar, ky objekt është marrë në dorëzim provizor në kundërshtim me kushtet e kontratës ku dëmi nga mos funksionimi i këtij objekti është **56,926,557** lekë në shpërdorim të detyrës, i cili është trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të auditimit.

### *Sa më sipër rekomandoj:*

-Bazuar në nenin 280,281 të K.Pr.P. kërkojmë, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, fillimin e procedimit penal për konsumin e veprës penale *shpërdorim detyre*, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në ngarkim të:



të cilët në përmbushje të detyrave të tyre funksionale kanë kryer veprime dhe mosveprime në kundërshtim me ligjin të cilat konsistojnë në marrjen në dorëzim provizor në një kohë që objekti është jashtë funksionit si pasojë e mungesës së studimit gjeologjik të paparashikuar nga projektuesi, e cila ka qënë evidente gjatë gjithë kohës së zhvillimit të punimeve, në kundërshtim me kushtet e kontratës ku për pasojë dëmi shkaktuar buxhetit të shtetit nga mos funksionimi i këtij objekti është në vlerën **56,926,557** lekë.

2. Nga auditimi mbi procedurat e prokurimit për vitin 2012 dhe konkretisht në tenderin me objekt “Furnizim me ujë i zonës së Kënetë, Durrës zona 8-14(shtesë kontrate), vlerë kontrate **38,520,000** lekë është konstatuar shmangie nga procedurat e prokurimit në kundërshtim me nenin 28 të LPP, kreu II, pika 1/c e VKM nr.1, dt 10.1.2007, të cilat kanë çuar në mungesën e konkurrencës dhe lindjen e pabarazisë së pjesmarrësve në tender, në kundërshtim me nenin 33, pika 5/a të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 me ndryshime, pasi nuk ekzistojnë kushtet për përzgjedhjen e procedurës së tenderimit “Negociim pa shpallje parapreke” të cilat janë trajtuar më hollësisht në Raport.

### *Sa më sipër rekomandojmë:*

-Bazuar në nenin 280,281 të K.Pr.P. kërkojmë, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, fillimin e procedimit penal për konsumin e veprës penale *shkelje e barazisë së pjesmarrësve në tendera apo ankande publike*, të parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal, në ngarkim të:

■■■ i cili në ushtrim të detyrës ka lejuar shkeljen e barazisë së pjesmarrësve në tendera apo ankande publike në tenderin me objekt “Furnizim me ujë i zonës së Kënetë, Durrës zona 8-14(shtesë kontrate), me vlerë kontrate **38,520,000** lekë, duke vepruar në kundërshtim me nenin 28 të LPP, kreu II, pika 1/c e VKM nr.1, dt 10.1.2007, pasi në

kundërshtim me nenin 33, pika 5/a të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 me ndryshime, nuk ekzistojnë kushtet për përzgjedhjen e procedurës së tenderimit “Negociim pa shpallje parapreke”.

3.Nga auditimi i zhvillimit të procedurave të prokurimit në tenderin me objekt “Furnizimi me ujë i plazheve Durrës Kavajë nga pusshpimet e Çermës loti III”, u konstatua se: Amendimi i kontratës nr.901/1, datë 05.4.2013 për lejimin e paradhënies në masën 10% të vlerës së kontratës (90,000,000 lekë) Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ”Alba Konstruksion & C.E.L.I. Cooperativa”, fitues i tenderit, është bërë në kundërshtim me nenin 10 “kushtet e vecanta” të kontratës nr. 901, datë 05.4.2013, ku nuk është parashikuar dhënia e fondeve buxhetore në formën e paradhënies, por është shtuar në nenin 10 të kontratës nr. 901, datë 05.4.2013, shënimi me shkrim dore “< ose=10 %” i cili është nënshkruar dhe vulosur nga ish Drejtori i Përgjithshëm ■■■, dhe në kundërshtim me Ligjin nr.119/2012, datë 17.12.2012 “Për Buxhetin e vitit 2013” dhe Udhëzimin nr.2, datë 06.02.2012 të Ministrisë së Financave, pika 147, duke kryer në këtë mënyrë fallsifikim të dokumentit zyrtar dhe njëkohësisht duke urdhëruar likuidimin e BOE, në shumën 90,000,000 lekë “paradhënie”. Veprimet e likuidimit të kësaj paradhënie në kundërshtim me aktet e sipërcituara janë kryer nga ■■■, me detyrë ish Përgjegjëse e Sektorit të Financës e komanduar.

Për këtë qëllim mëqënëse shkeljet e konstatuara përbëjnë haptazi vepër penale, në zbatim të nenit 280, 281 të K.Pr.Penale me shkresën nr.731/4 datë 18.11.2013 është bërë kallëzim penal që në fazën e hartimit të Projektraportit të auditimit, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në ngarkim të z. ■■■ ish Drejtori i Përgjithshëm, për veprën penale të “shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga neni 248 i K.Penal dhe veprën penale të “fallsifikimit të dokumentave” parashikuar nga neni 186 i K.Penal dhe znj. ■■■ me detyrë ish Përgjegjëse e Sektorit të Financës e komanduar.

*Shënim:* Auditimi u krye nga audituesit Miranda HAXHIA p/grupi, Pjetër Beleshi,Valentina Sulo, Marjola Llanaj dhe Alush Zaçe, më tej materiali u shqyrtua nga Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal YZEIRAJ, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Departamentit Manjola NAÇO dhe Sekretari i Përgjithshëm znj. Luljeta Nano.